



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:133364

Datë: 06.12.2023

Numri i dokumentit: 05022861

**P.nr. 709/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B. nga fsh. G. K. P, i akuzuar për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 1364/20, të datës 19.10.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 04.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit A.B, mbrojtëses së tij av. S. A, caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 06.12.2023, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**A. (D.) B**, i lindur me datë..., në fsh. G. K. P., ku edhe banon, i lindur nga babai D. dhe nëna T., e vajzërisë K, me profesion punëtor në bujqësi, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të numrit personal..., i martuar, baba i 4 (katër) fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e**

Me datë 25.07.2020, rreth orës 17 :50, në rrugën regjionale P. – D. në fsh. R. K. P, nga pakujdesia ka shkelur ligjin për rregullat në trafikun rrugor nga neni 61 par.1, në atë mënyrë që i pandehuri duke qarkulluar me veturën e tij të llojit VW-Golf ngjyrë e kuqe me targa të regjistrimit..., nga drejtimi i P. për në drejtim të D. , ku me të arritur në vendin e lartcekur duke mos e respektuar përparësinë e kalimit nga përball kalimi, i ndërpret rrugën drejtuesit të motoçikletës “...” me ngjyrë të zezë të cilën e drejtonte i dëmtuari L. I, ashtu që nga ana e djathtë kalon në anën e majtë të rrugës, ashtu që në pamundësi që ti shmanget goditjes, i dëmtuari me pjesën e parë ballore të motoçikletës përplasat në veturën ..., në pjesën e parë të djathtë, ku

si pasojë e kësaj i njëjti pëson lëndime të rënda trupore, me thyerje të unazave 1 dhe 3 lumbale të shtyllës kurrizore.

- me çka ka kryer veprën penale “*rrezikimi i trafikut publik*” nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6, të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 7, 38, 39,40,42, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 370 par. 8 lidhur me par. 6, të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim ndaj të pandehurit nuk do të ekzekutohet, nëse brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vite, nuk do të kryej veprë tjetër penale.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve për ekspertizë mjekoligjore të paguajë shumën prej 20 (njëzet) euro dhe në emër të shpenzimeve për ekspertizë të komunikacionit rrugor të paguajë shumën prej 51,10 (pesëdhjetë e një euro e dhjetë centë) €, gjithsejtë shumën prej 71,10 (shtatëdhjetë e një euro e dhjetë cent) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar L. I. nga fsh. R. K. P, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 19.10.2020 ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1364/20, ndaj të pandehurit A.B, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 04.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit A.B dhe mbrojtëses së tij av. S. A, caktuar sipas detyrës zyrtare, ndërsa pala e dëmtuar ka munguar edhe pse nga procesverbali i datës 31.10.2023 gjykata ka njoftuar të njëjtin për datë të seancës, mirëpo i njëjti nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 të KPPK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës ka të angazhuar av. S. A, caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.1364/20 të datës 19.10.2020 nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është i bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pasojat e mospranimin.

I pandehuri A.B. deklarojë që e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, duke shtuar se nuk ka qenë e qëllimshme, me palën e dëmtuar janë pajtuar dhe e ka vizituar, i ka dhënë ndihmën e parë, duke deklaruar se pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, deklarojë që ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe pranimi i fajësisë ti merret si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësja e të pandehurit av. S. A. deklarojë që e mbështesë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimit, i propozojë gjykatës që ta marr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, dhënien e ndihmës së parë në vendin e ngjarjes, pajtimin me palën e dëmtuar, si dhe mundësisht të i shqiptoj një dënim me kusht ngase i njëjti ka kryer veprën penale nga pakujdesia, ku kanë ndikuar edhe rrethanat tjera si kushtet atmosferike.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 dhe par. 6 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza, edhe atë: Raporti i aksidentit i datës 09.08.2020, nr. rasti..., skica e vendit të ngjarjes, deklarata e të pandehurit A.B, e dhënë në Stacionin Policor në Pejë, me datë 22.07.2020 si dhe prokurorinë Themelore në Pejë me dt. 16.10.2020, deklarata e palës së dëmtuar L. I, e marrë në shtëpi nga ana e zyrtarit policor, me datë 08.08.2020, fletëlëshimi me epikrizë i evidentuar nën numrin rendor nr.29637, i datës 08.08.2020, lëshuar nga S. O. për otorinolaringologji dhe ortopedi i nënshkruar nga Dr. A. A., ekspertiza e ekspertit të komunikacionit rrugor e punuar nga Ing. Dip. K. R, e datës 24.09.2020, akt ekspertimi mjekoligjor i Dr. M. G. me nr. të referencë .... të datës 30.09.2020 në emër të të dëmtuarit L. I, 6 foto nga vendi i ngjarjes, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj gjykata konform nenit 242 par.6, mori aktvendim me të cilin pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit A.B. për veprën penale ‘rrezikimi i trafikut publik’ nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A.B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurit ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjëse. Sa i përket fajësisë së të pandehurit, i njëjti është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, përmirësimin e raporteve me palën e dëmtuar, sjelljen e të pandehurit pas ngjarjes, i pandehuri është prindër i katër fëmijëve dhe mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ka të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.6, të KPPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimet për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë euro) €.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2, nën par.2.1 të KPPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimeve për ekspertizë mjekoligjore të paguajë shumën prej 20 (njëzetë) euro dhe në emër të shpenzimeve për ekspertizë të komunikacionit rrugor të e paguajë shumën prej 51,10 (pesëdhjetë e një euro e dhjetë centë) €, e gjithsejtë shumën prej 71,10 (shtatëdhjetë e një euro e dhjetë cent) €.

Konform nenit 449 par 2 nën par. 2.9 të KPPRK-së dhe nenin 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil konform nenit 462 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.709/20, datë 06.12.2023**

**Bashkëpunëtorë Profesionale**  
Kaltrina Rexhepi - Imami

**GJYQTARI**  
Veton Ademaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,

Numri i lëndës: 2020:133364  
Datë: 06.12.2023  
Numri i dokumentit: 05022861

Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.